



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga “MIGJENI” (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

Psh. nr. 587/22

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, nenin 108/A paragrafi 7 dhe neni 109 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, nenin 9 i “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave”, si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020 e amendamentuar me datën 30. 09. 2022, pas shqyrtimit të ankesës së OE “MONUNI sh.p.k Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor ” me numër të prokurimit 616-22-10416-2-1-1 dhe numër të brendshëm: 616 22 83 211, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Kuvendi i Komunës së Prishtinës, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën: 3 nëntor 2022, mori këtë:

VENDIM

Hedhet si e jashtafatshme, ankesa e OE “MONUNI sh.p.k Gjilan , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor ” me numër të prokurimit 616-22-10416-2-1-1 dhe numër të brendshëm: 616 22 83 211, iniciuar nga (AK) Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

I lejohet, autoritetit kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor ” me numër të prokurimit 616-22-10416-2-1-1 dhe numër të brendshëm: 616 22 83 211, përkitazi me këtë ankesë nëse nuk ka ankesë tjetër.

Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të

kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale

Autoriteti Kontraktues- Kuvendi i Komunës së Prishtinës për aktivitetin e prokurimit timit “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor ” me numër të prokurimit 616-22-10416-2-1-1 dhe numër të brendshëm: 616 22 83 211, me datën 29.09.2022 ka publikuar B-05 - Njoftimin për kantatë , afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data 31.10.2022.

Në sistemin e prokurimit figuron që OE ankues kërkesën për rishqyrtim e ka dorëzuar me datën 12.10.2022

AK me datën 12.10.2022 ka kthyer përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

OE i pa kënaqur me këtë vendim me datën 25.10.2022 parashtron ankesë në OSHP.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vlerësohet se duke pas parasysh faktin se AK ka publikuar vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim 12.10.2022, afati ligjor për ankesë për OE ankues në Organi Shqyrtues të Prokurimit ka filluar të rrjedhë nga data 13.10.2022, duke filluar nga ora 08:00 deri në orën 16:00 dhe ky afat ligjor ka përfunduar me datën 24.10.2022 në ora 16:00.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 5 i LPP-së specifikon :

Kalkulimi i afateve kohore

1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se OE ankues ankesën me numër të protokollit 587/2022, e ka parashtruar në kundërshtim me neni 109 të LPP-së sepse neni 109 i LPP-së specifikon:

Afatet për Dorëzimin e Ankesës

1. Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të

mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

2. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Po ashtu edhe neni 9 paragrafi 1 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimit të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon: Ankesa pranë OSHP-së, duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart OSHP konstatoj se ankesa e parashtruar në OSHP nga OE “MONUNI sh.p.k Gjilan, me numër te protokollit 587/2022, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor ” me numër të prokurimit 616-22-10416-2-1-1 dhe numër të brendshëm: 616 22 83 211, iniciuar nga (AK) Kuvendi i Komunës së Prishtinës, hedhet si e jashtafatshme sepse ankuesi ka parashtruar ankesë në OSHP në kundërshtim me nenin 108/A dhe 109 të LPP-së si dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimit të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj duke u bazuar në sqarimet e dhëna si më lart e njëjta ankesë nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Kuvendi i Komunës së Prishtinës

1x1 OE“MONUNI sh.p.k Gjilan

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së


Kryetarja e OSHP-së
Vjosa Gradinaj Mexhuani